

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2011

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin kushtetues të Bankës së Shqipërisë për zbatimin e pavarur të politikës monetare;

Duke njohur objektivat afatmesëm e vjetorë, si dhe detyrimet ligjore të institucionit;

Duke marrë në konsideratë ndikimin e zhvillimeve ekonomike botërore, rajonale e kombëtare në politikën monetare të ndjekur nga institucioni;

Duke mbështetur dhe nxitur bashkëpunimin me këtë institucion,

Konstaton se gjatë vitit 2011 Banka e Shqipërisë:

- Ka ndjekur një politikë monetare të kujdesshme dhe efektive, duke krijuar kushte lehtësuese monetare për rritjen ekonomike dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik e financiar të vendit.

- Ka realizuar objektivin e saj kryesor, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, duke e mbajtur nivelin e inflacionit brenda kufijve të programuar.

- Ka harmonizuar politikën monetare me atë fiskale, duke rritur likuiditetin dhe stimulim monetar në ekonomi dhe duke nxitur zhvillimin e tregut të brendshëm financiar.

- Ka forcuar rolin mbikëqyrës dhe rregullator ndaj sistemit bankar e financiar, duke i dhënë përparësi rritjes së nivelit të kapitalit dhe të provigjoneve, me synim ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar.

- Ka ndikuar në rritjen e kreditimit të biznesit dhe reduktimin e kostove të tij, duke kontribuar në zgjerimin e investimeve të sektorit privat.

- Ka menaxhuar me ekonomi rezervën valutore, duke e investuar me efektivitet dhe ka ruajtur një normë optimale të saj.

- Ka luajtur rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen dhe transparencën e çështjeve që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave.

- Ka ndikuar në rritjen e efikasitetit dhe të qëndrueshmërisë së sistemeve të pagesave, përmirësimin e infrastrukturës teknologjike dhe zhvillimin e produkteve të reja të pagesave.

- Ka mbështetur proceset integruese të vendit tonë në BE dhe ka mbajtur marrëdhënie bashkëpunuese me institucionet kryesore financiare kombëtare e ndërkombëtare.

Kuvendi kërkon që, për vitin 2012, Banka e Shqipërisë të përqendrojë punën në këto drejtime:

- Vijimin e politikave për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, sipas objektivave të programit monetar.

- Thellimin e koordinimit të politikave monetare me ato fiskale, duke synuar mbështetjen e rritjes ekonomike, mbi bazën e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm afatmesëm dhe afatgjatë të saj.

- Forcimin e pavarësisë së vendimmarrjes dhe rritjen e profesionalizmit të stafit të institucionit, me synim rritjen e efektivitetit të vendimeve të politikës monetare.

- Forcimin e mbikëqyrjes së sistemit bankar e financiar, duke adaptuar rregullat dhe parimet më të forta për një mbikëqyrje të kujdesshme të veprimtarisë së sektorit, si dhe duke kërkuar nga sistemi bankar zbatimin e modeleve të suksesshme në menaxhimin e riskut.

- Aplikimin e politikave, si dhe bashkëpunimin me sistemin bankar për rritjen e masës, efektivitetit dhe përmirësimin cilësor të kreditimit, ndikimin me vendimmarrjen e saj në shëndoshjen e portofolit të kredive, duke asistuar riskedulimin e kredive me rregulla, udhëzime dhe procedura.

- Zgjerimin e bashkëpunimit dhe vendosjen e sistemit të raportimit elektronik nga subjektet financiare që raportojnë pranë Bankës së Shqipërisë.

- Përafrimin e kuadrit rregullator dhe të praktikave të punës së institucionit me ato të Bankës Qendrore Europiane, si dhe sigurimin e mbështetjes teknike e profesionale për ndryshimet ligjore në fushën e ekzekutimit të kolateralit.

- Thellimin e punës studimore, me qëllim mbështetjen e vendimmarrjes së politikave ekonomike në njohjen empirike dhe praktikave më të mira, duke u fokusuar, veçanërisht, në përmirësimin e modelit

makroekonomik dhe në aftësinë parashikuese të inflacionit dhe ndryshoreve të tjera makroekonomike.

- Përmirësimin e sasisë dhe cilësisë së statistikave të prodhuara nga institucioni, si dhe rritjen e transparencës ndaj publikut.

7 qershor 2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)